



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 07, Datë 16.01.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 167, DATË  
28.06.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE”  
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENER GjISË ELEKTRIKE”, I  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94 prot., datë 12.01.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.06.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 167, datë 28.06.2022, të ndryshuar me vendimin e bordit nr. 209, datë 17.08.2022, ka vendosur:
  1. Të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
  2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.
  3. Shfuqizuar.
  4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 01.03.2023.
  5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.06.2022.

- Me dokumentacionin e depozituar me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/10 prot., datë 10.10.2022, nr. 469/12 prot., datë 30.11.2022, dhe nr. 469/14 prot., datë 06.01.2023, shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 2 dhe pikën 4 të vendimit të bordit të ERE nr. 167/2022, i ndryshuar, ndaj si të tilla këto kushte vlerësohet të shfuqizohen.
- Duke qenë se me shfuqizimin e pikave 2 dhe 4 të vendimit të bordit të ERE nr. 167/2022, i ndryshuar, dhe me plotësimin e të gjitha kushteve të këtij vendimi nuk gjen më zbatim as pika 5 e këtij vendimi, vlerësohet edhe shfuqizimi i saj.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të shfuqizojë pikën 2, pikën 4 dhe pikën 5 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.06.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**